



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
PROCEDURAT E AKREDITIMIT DHE RREGULLAT E VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE NGA ORGANIZATAT
JOQEVERITARE SHQIPTARE DHE TË HUAJA, ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, PËRFAQËSUES TË
SHTETEVE TË HUAJA DHE MEDIAVE

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, përcakton në nenet 6 dhe 7 të tij, të drejtën e organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatave ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesve të shteteve të huaja dhe të medias, për të dërguar vëzhgues në zgjedhje, si dhe të drejtat dhe detyrat e tyre.

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat për akreditimin, të drejtat, detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe mediave.

Ky projektvendim vjen në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, si dhe në reflektim të plotë të rolit dhe rëndësisë së vëzhguesve zgjedhorë, në çdo fazë të procesit ku ata akreditohen. Përcaktimi i procedurave të akreditimit, të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve si dhe rregullat tërësore të vëzhgimit të zgjedhjeve, mundësojnë përmbushjen me profesionalizëm të detyrës nga ana e tyre.



Projektvendimi ka në përmbajtjen e tij 8 nene, të ndara si më poshtë vijon:

- Neni 1 përcakton objektin e projektvendimit;
- Neni 2 parashikon procedurën e dorëzimit të kërkesës për akreditimin e vëzhguesve;
- Neni 3 përcakton procedurën e verifikimit të dokumentacionit nga KQZ-ja dhe vendimmarrjen e saj;
- Neni 4 parashikon kohëzgjatjen e vëzhgimit, në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- Nenet 5 dhe 6 përcaktojnë të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve dhe medias së akredituar;
- Neni 7 shfuqizon udhëzimin nr. 2, datë 02.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave dhe subjektet zgjedhore”;
- Neni 8 parashikon hyrjen në fuqi të tij.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”.

Madalena KOJA - Drejtorja Juridike dhe Dokumentacionit Zgjedhor

Aurel LAMÇE - Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**PROCEDURAT E AKREDITIMIT DHE RREGULLAT E VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE NGA ORGANIZATAT
JOQEVERITARE SHQIPTARE DHE TË HUAJA, ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, PËRFAQËSUES TË
SHTETEVE TË HUAJA DHE MEDIAVE**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

Neni 1

Objekti

Ky vendim përcakton rregullat për akreditimin, të drejtat, detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe mediave.

Neni 2

Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e vëzhguesve

1. OJF-të shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe media, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin pranë KQZ-së dokumentacionin e mëposhtëm:

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave.

- a) Kërkesë nga drejtuesi apo përfaqësuesi i organizatës/medias që kërkon të vëzhgojë procesin zgjedhor. Kërkesa përmban adresën, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të kontaktit të aplikuesit.
 - b) Vërtetimin e regjistrimit (të përditësuar 3-6 muajt e fundit) në gjykatë ose në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe/ose ftesën përkatëse. Për akreditimin e gazetarëve të huaj depozitohet dokumenti i vlefshëm i akreditimit nga MEPJ.
 - c) Listën e veçantë për vëzhguesit afatgjatë/afatshkurtër/përkthyesit e propozuar/përfaqësuesit e medias të propozuar, në formë shkresore edhe në format elektronik EXCEL, sipas Modelit KQZ-xx-xx, në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Aplikuesit shqiptarë, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së zgjedhjeve.
 3. Aplikuesit e huaj duhet të paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, jo më vonë se shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara datës së zgjedhjeve.
 4. Aplikuesi për t'u akredituar si vëzhgues mban përgjegjësi për saktësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe për të dhënat personale të paraqitura për secilin prej vëzhguesve të propozuar.

Neni 3

Verifikimi i dokumentacionit dhe vendimmarrja e KQZ

1. KQZ bën verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe nëse dokumentet janë të plota dhe të nënshkruara bën akreditimin jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e tyre.
2. Nëse dokumentet për akreditimin, janë jo të plota ose të pasakta KQZ i kërkon aplikuesit të bëjë korrigjimet e vëna në dukje dhe të ridorëzojë dokumentet brenda 24 orëve nga njoftimi. Aplikuesi nuk akreditohet nëse nuk ridepoziton dokumentacionin e korrigjuar brenda afatit.
3. Pas marrjes së vendimit për akreditim, KQZ pajis vëzhguesit me autorizimin e akreditimit, sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi në lidhjen nr. 2.
4. Autorizimi për vëzhgim është i vlefshëm për zonën zgjedhore, qendra votimi apo vend numërimi të votave, sipas përcaktimit në kërkesën e aplikuesit dhe i jep vëzhguesit të drejtën të hyjë dhe të qëndrojë në ambientet e tyre duke përmbushur të drejtat dhe detyrat e vëzhguesit.

Neni 4

Kohëzgjatja e vëzhgimit

1. Vëzhguesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Vëzhgues afatgjatë konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin nga momenti i akreditimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

3. Vëzhgues afatshkurtër konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin 24 (njëzet e katër) orë para ditës së zgjedhjeve deri në përfundimin e procesit të numërimit / shpalljes së rezultateve.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:
 - a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
 - b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
 - c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;
 - d) t'u drejtojnë pyetje komisionit zgjedhor përkatës, pa penguar në veprimtarinë e tij;
 - e) të hyjnë dhe të dalin pa pengesa në ambientet zgjedhore.
2. Vëzhguesit kanë këto detyra:
 - a) të respektojnë kërkesat e këtij Kodi dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;
 - b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti apo koalicion në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas këtij Kodi;
 - c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KQZ-ja;
 - d) të mos mbajnë shenja dalluese, që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;
 - e) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.
 - f) të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor, në procedurat e ditës së votimit, në procesin e numërimit të votave, në procesin e nxjerrjes së rezultatit dhe aktivitetin e komisioneve zgjedhore;
 - g) të respektojnë rregullat e etikës në ambientet zgjedhore;
 - h) të mos komentojnë dhe/ose debatojnë vendimet e KQV/KZAZ/GNV dhe procesin e votimit;
 - i) të mos marrin ose japin intervista, të mos kryejnë sondazhe me votuesit brenda qendrës së votimit dhe jashtë saj deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) metra distancë nga qendrat e votimit.

Neni 6

Të drejta dhe detyrat e medias së akredituar

1. Vëzhguesit e medias së akredituar krahas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në nenin 6 të këtij vendimi, kanë të drejtë të përdorin kamera në qendrën e votimit por pa ndërhyrë dhe pa penguar procesin e votimit. Ata nuk mund të qëndrojnë në ambientet e qendrës së votimit më shumë se 15 minuta dhe në çdo rast duhet të ruajnë fshehtësinë e zgjedhësit në procesin e tij të votimit.
2. Vëzhguesit e medias së akredituar mund të instalojnë kamera apo pajisje të tjera ndihmëse në vend numërimit të votave dhe mund të transmetojnë ecurinë e procesit të numërimit pa ndërhyrë dhe pa ndikuar në veprimtarinë e KZAZ-së dhe grupeve të numërimit.

Neni 7

Shfuqizime

Udhëzimi nr.2, datë 02.02.2021, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave dhe subjektet zgjedhore", shfuqizohet.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave.

Lista Vëzhguesve Afatgjatë/Afatshkurtër/Përkthyes/Media për akreditim
bashkëlidhur me kërkesë

Nr. Prot __ datë /__ / __ / __ të _____ (emri i organizatës/Medias)

NR.	EMËR	MBIEMËR	ORGANIZATA	MANDATI	SHTETËSIA	DT. LINDJE (dd.mm.vvvv)	NR. DOKUMENT IDENTIFIKIMI	ZONA E VEZHGIMIT	VLEFSHMËRIA	GJINIA

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të
zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja,
organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja
dhe mediave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	REPUBLIC OF ALBANIA CENTRAL ELECTION COMMISSION	REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	REPUBLIC OF ALBANIA CENTRAL ELECTION COMMISSION	REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	REPUBLIC OF ALBANIA CENTRAL ELECTION COMMISSION	REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	REPUBLIC OF ALBANIA CENTRAL ELECTION COMMISSION
VËZHGUES OBSERVER Afatgjatë Long Term		VËZHGUES OBSERVER Afatshkurtër Short-Term		VËZHGUES OBSERVER Përkthyes Translator		VËZHGUES OBSERVER Media Media	
Emri/Name		Emri/Name		Emri/Name		Emri/Name	
Mbiemri/Surname		Mbiemri/Surname		Mbiemri/Surname		Mbiemri/Surname	
Organizata/ Organisation		Organizata/ Organisation		Organizata/ Organisation		Organizata/ Organisation	
Nr. rendor/Serial No.		Nr. rendor/Serial No.		Nr. rendor/Serial No.		Nr. rendor/Serial No.	
 Ilirjan CELIBASHI Kryetar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		 Ilirjan CELIBASHI Kryetar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		 Ilirjan CELIBASHI Kryetar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		 Ilirjan CELIBASHI Kryetar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	
Vlefshmeri/Valid Until: 14.06.2023 Ky autorizim shoqërohet me një identifikues/Accompanied by ID document		Vlefshmeri/Valid Until: 14.06.2023 Ky autorizim shoqërohet me një identifikues/Accompanied by ID document		Vlefshmeri/Valid Until: 14.06.2023 Ky autorizim shoqërohet me një identifikues/Accompanied by ID document		Vlefshmeri/Valid Until: 14.06.2023 Ky autorizim shoqërohet me një identifikues/Accompanied by ID document	

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION	KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION	KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION	KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION
			
VËZHGUES OBSERVER ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE LOCAL GOVERNMENT ELECTION			
SKANO PËR NDËHJE SCAN FOR HELP			
14.05.2023			

Lidhja 5
KQZ-09-15
Autorizimi për përkthyesin

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË | REPUBLIC OF ALBANIA
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE | CENTRAL ELECTION COMMISSION

VËZHgues | **OBSERVER**

Përkthyes | **Translator**

Emri/Name

Mbiemri/Surname

Organizata/
Organisation

Nr. rendor/Serial No.



Ilirjan CELIBASHI
Komisioneri Shtetëror
i Zgjedhjeve

Vlefshmëria:/Valid Until: 14.06.2023
 Ky autorizim shoqërohet me mjet identifikimi/Accompanied by ID document

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
CENTRAL ELECTION COMMISSION



VËZHgues
OBSERVER

ZGJEDHJET PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE
LOCAL GOVERNMENT ELECTION

SKANO PËR
NDIHMË

SCAN FOR
HELP

14.05.2023

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediae.